

## PËRMBLEDHJE

### MBI DRAFTIN E STRATEGJISË KOMBËTARE TË INDUSTRISË 2026–2030, DHE TË PLANIT TË SAJ TË VEPRIMIT

*Qershor 2026*

\*\*\*

Më 4 qershor 2026 në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike<sup>1</sup> u publikua për konsultim publik drafti i “*Strategjisë Kombëtare të Industrisë 2026–2030, dhe të Planit të Saj të Veprimit*” (“*Dokumenti*”) i shoqëruar me Relacionin dhe Dokumentin Shoqërues. Përmbledhja përfshin vetëm disa nga elementet kryesore të Dokumentit të cilat mund të jenë objekt pyetjesh, komentesh, sugjerimesh apo debati në mbledhjen e Këshillit të Investimeve (KI) të datës 30 qershor 2026.

Strategjia Kombëtare Industriale 2026–2030 synon të krijojë bazat për transformimin strukturor të ekonomisë shqiptare përmes zhvillimit të industrisë, rritjes së produktivitetit, forcimit të eksporteve dhe integritit më të thellë në zinxhirët evropianë dhe globalë të vlerës. Strategjia mbështetet në potencialin e pashfrytëzuar të sektorit industrial, pozicionin strategjik të Shqipërisë, procesin e integritit evropian dhe interesin në rritje të investitorëve ndërkombëtarë për të nxitur një model zhvillimi të bazuar në inovacion, teknologji dhe vlerë të shtuar.

Sipas draftit industria përpunuese përfaqëson aktualisht një pjesë relativisht të kufizuar të ekonomisë shqiptare, vendi disponon mundësi të konsiderueshme për zgjerimin e kapaciteteve prodhuese, modernizimin teknologjik dhe zhvillimin e sektorëve me potencial të lartë eksportues. Tendencat ndërkombëtare të rikonfigurimit të zinxhirëve të furnizimit, afërsia me tregun e Bashkimit Evropian dhe reformat e vazhdueshme institucionale krijojnë kushte të favorshme për tërheqjen e investimeve dhe rritjen e rolit të industrisë në ekonomi.

Dokumenti përbën gjithashtu instrumentin kryesor për përmbushjen e kërkesave të Kapitullit 20 të acquis të Bashkimit Evropian – Ndërmarrjet dhe Politika Industriale, duke siguruar përfrimin e politikave industriale shqiptare me prioritetet e BE-së për një industri të gjelbër, digjitale dhe konkurruese. Ajo parashikon mekanizma qeverisjeje, koordinimi ndër-institucional, monitorimi dhe zbatimi. Dokumenti përafron në total 5 kapituj të EU Acquis: Kapitulli 20 – Ndërmarrjet e Mesme dhe të Vogla dhe Politikat Industriale; Kapitulli 25 – Shkenca dhe Kërkimi; Kapitulli 2 – Lëvizja e Lirë e Punëtorëve; Kapitulli 19 – Politikat Sociale dhe të Punësimit dhe Kapitulli 27 – Mjedisi. Ndërkohë që një Matricë Përputhshmërie është përgatitur për të siguruar koherencë me 7 Strategji të tjera horizontale dhe vertikale në RSh.

<sup>1</sup> <https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/987>

Dokumenti synon gjithashtu të krijojë një kuadër të unifikuar për koordinimin e politikave, orientimin e investimeve dhe zhvillimin e sektorëve me potencial të lartë, me synimin për të rritur konkurrueshmërinë e ekonomisë shqiptare, për të zgjeruar eksportet dhe për të gjeneruar vende pune me produktivitet dhe paga më të larta.

Qëllimet strategjike janë 4:

(a) ***Transformimi i sistemeve të prodhimit*** – Synon modernizimin e bazës industriale shqiptare përmes integritit të tranzicionit të gjelbër, transformimit digjital dhe përdorimit efikas të burimeve, me qëllim rritjen e produktivitetit, avancimin teknologjik dhe forcimin e konkurrueshmërisë deri në vitin 2030;

(b) ***Integrimi në ekosistemet industriale evropiane dhe zinxhirët e vlerës*** – Synon rritjen e integritit të industrisë shqiptare në tregun e BE-së dhe në zinxhirët evropianë të vlerës, përmes forcimit të eksporteve, përafrimit me standardet evropiane dhe pozicionimit të Shqipërisë si partner strategjik në furnizimin me lëndë të para kritike.

(c) ***Ekosisteme dinamike të inovacionit industrial*** – Synon zhvillimin e inovacionit dhe teknologjisë industriale duke nxitur bashkëpunimin ndërmjet industrisë dhe kërkimit shkencor, përhapjen e teknologjive të reja dhe krijimin e mundësive të reja për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

(d) ***Arkitekturë koherente e zhvillimit industrial*** – Synon krijimin e një sistemi të integruar të qeverisjes, financimit dhe zhvillimit të aftësive që mbështet infrastrukturën moderne industriale, zhvillimin e zonave industriale, investimet dhe rritjen e qëndrueshme të sektorit industrial.